



**Organizata Jo-Qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe  
EC MA NDRYSHE**

**Njoftim nga takimi i kryetarit me drejtorët e komunës  
Ekzekutivi lokal mbështet "Ditën e Rinisë 2013"**

*28 gusht 2013, Prizren*

EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit "Transparenca online e Komunës së Prizrenit" ka marrë pjesë në mbledhjen e radhës të kryetarit të komunës, Ramadan Muja me drejtorët komunal, ku janë miratuar disa konkluzione.

Qeveria komunale e Prizrenit ka miratuar propozimin e DKRS-së për mbështetje financiare rreth organizimit të manifestimit "Dita e Rinisë 2013", i cili këtë vit shënohet për herë të dymbëdhjetë si aktivitet gjithëpërfshirës në Sektorin e Rinisë, në organizim të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe MKRS-së.

Bartës të projektit do të jenë: Këshilli i Veprimit Rinor Lokal, Qendra Rinore, Këshilli i nxënësve të shkollave të mesme dhe OJQ-të rinore. Aktivitetet do të përfshijnë: Përrurime të objekteve rinore, Konferencë, Gara sportive, Ekspozitë, kampanjë informuese rreth punës së akterëve rinor, aksion për dhurim vullnetar të gjakut si dhe në përmbyllje koncertin në sheshin Shadërvan. E gjithë nisma do të përkrahet dhe mbulohet nga komuna në shumë prej 2,500 euro.

Në këtë mbledhje është shqyrtuar edhe propozimi i Drejtorisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale për formimin e komisionit tre anëtarësh për hartimin e Planit të veprimit për banim si dhe është proceduar në Komitetin për Politikë dhe Financa programi i projektit për banim në komunën e Prizrenit për periudhën tre vjeçare 2013-2015.

Ka kaluar edhe propozimi nga kjo drejtori për udhëtimin zyrtar të dy zyrtarëve për në Dresden të Gjermanisë për trajnim gjashtë ditor, me temë Programi për Mbrojtje sociale dhe Parandalimin e Trafikimit me qenie njerëzore në Kosovë, për pagesë të mëditjeve.

Me 1 000 euro mbështetje financiare nga ky takim e propozuar nga DPMS, veteranëve të luftës nga komuna e Prizrenit, u mundësohet shkuarja për pushime në bregdet.

Drejtorisë për Emergjencë i është aprovuar kërkesa për lejimin e hapjes së tenderit për furnizim me uniforma verore dhe dimërore për zjarrfikësit, si dhe kërkesa në lidhje me nxjerrjen e konkluzionit për ushqimin e tyre në terren.

Nga Drejtorija për Bujqësi është kërkuar nxjerrja e konkluzionit në lidhje me punësimin e katër punonjësve sezonal respektivisht rojtarë pyjesh me afat kohor të punës për tre muaj.

Qeveria lokale ka miratuar edhe propozimin e Drejtorisë së Administratës për lejimin e shpalljes së tenderit për izolimin me grila të zyrave të gjendjes civile në Lubizhdë të qytetit, në Reçan, në Mushnikovë dhe në Lubinjë e Poshtme, të gjitha për sigurimin e objekteve të zyrave në fjalë.

Në këtë takim janë miratuar edhe disa kërkesa në lidhje me mbështetjen financiare të pacientëve me sëmundje të rënda.

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së ekzekutivit do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe përmes ueb-faqes së

projektit, ku të gjeturat postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Tanimë të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeverinë lokale të Prizrenit dhe të Mamushës publikohen në baza të rregullta në ueb-faqen e projektit, [www.online-transparency.org](http://www.online-transparency.org)

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj,

Elmedina Baxhaku, Monitoruese  
OJQ EC Ma Ndryshe  
Rr.Saraqët, Nr. 5 - Prizren  
Rr. Zeki Shulemaja, Nr. 2 - Prishtinë  
[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org) & [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)  
+381 38 224 967 & +381 29 222 771



British Embassy  
Pristina

*Projekti "Transparenca online e komunave të Prizrenit dhe Mamushës" prej muajit maj 2013 përkrahët financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.*